

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.Br 149/2025	Data: Datum: 31.07.2025	

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika d), nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 5, paragrafi 1, nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 26, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/2010, në harmoni të plotë edhe me Hartën Zonale të Komunës së Istogut HZK 2024-2032, pas rishqyrtimit të vendimit 00.Nr.127/2025 i datës 25.06.2025, që në mbledhjen e planifikuar për tu mbajtur më 31.07.2025 të merr këtë :

V E N D I M P Ë R R I S H Q Y R T I M I N E V E N D I M I T 00 NR.127/2025 T Ë D A T Ë S
25.06.2025 P Ë R C A K T I M I N E L O K A C I O N I T (N D A R J E N E P R O N Ë S) M Ë
DESTINIM P Ë R V A R R E Z A T Ë F S H A T I T R A K O S H N G A P R O N A E
P A L U A J T S H M E E K O M U N Ë S

1. Të ndahet caktohet prona e paluajtshme komunale me (destinim) për varreza të fshatit Rakosh, saktësisht pjesa e sipërfaqes prej (12000)m² pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut nga pjesa e përgjithshme e sipërfaqes prej (162119)m² nga njësia kadastrale e evidentuar sipas parcelës me nr.P-70806042-00335-0, zona kadastrale Rakosh pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut.
2. Qëllimi i ndarjes (caktimit) se pronës komunale me lokacion dhe (destinim) të përcaktuar si në piken 1 të këtij propozim vendim është i bazuar në kërkesën e banoreve si rezultat i mungesës së hapësirës ekzistuese për varreza të fshatit me qëllim të sigurimit të një hapësire më të madhe, kërkesë kjo e komunitetit e paraqitur përmes përfaqësuesit të tyre.
3. Më qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik propozohet ndarja e pronës (caktimi i lokacionit) me destinim, pozicion dhe sipërfaqe të caktuar si në piken 1 të këtij vendimi, njëkohësisht i bazuar edhe në kërkesën e komunitetit të fshatit Rakosh K,Istog.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.
5. Për zbatimin të këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Departamenti për çështje pronësore.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

 REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK DREJTORIA PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA UPRAVLJENJA	
11	
Nr./Br. <u>001-039-10</u> Nr. i faq./Br.str. <u>1</u>	
Data/Datum <u>06 / 08 / 2025</u>	
ISTOG - ISTOK	

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

E Rugova

